



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 185 Prot

Tiranë, më 22.02.2022

V E N D I M

Nr.29, datë 22.02.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN AUTORITETI I
MEDIAVE AUDIOVIZIVE DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT
TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 66 (660 prot.), datë 8.6.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për

nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, “fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë aplikimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, për periudhën janar 2018 – maj 2021.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 660/1 prot., datë 8.6.2021, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili, me shkresën nr. 660/2 prot., datë 8.6.2021, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive”*, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nga ku rezultuan disa parregullsi.

Institucioni i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 3600/1 prot., dt. 19.11.2021, *“Kthim përgjigje”* dhe shkresat *“Përcjellje dokumentacioni”* me nr. 3822 prot., dt. 6.12.2021 e nr. 3822/1 prot., dt. 7.12.2021, ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me observacionet si dhe dokumentacionin e marrë pranë institucioneve përkatëse në lidhje me eksperiencën e punës në profesion të kandidatit të shpallur fitues në procedurën e konkurrimit për pozicionin *“Sekretar i Përgjithshëm në Autoritetin e Mediave Audiovizive”*.

Ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, me shkresën datë 26.11.2021, ka dërguar observacionet si dhe dokumentacionin përkatës që tregon eksperiencën në profesion në momentin e aplikimit për të marrë pjesë në konkurrimin për pozicionin *“Sekretar i Përgjithshëm në Autoritetin e Mediave Audiovizive”*.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar dhe nëpunësve të përmendur në përmbajtjen e materialeve për parregullsi, për të shprehur pretendimet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në lidhje me punonjësin *****, i cili në momentin e kryerjes së konkurrimit për pozicionin “Specialist në Sektorin e Inspektiveve”, në Drejtorinë e Mbikëqyrjes, në institucionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, nuk plotësonte kërkesat e posaçme ligjore për t’u punësuar dhe për të fituar statusin e nëpunësit civil në këtë pozicion, njësia përgjegjëse e institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, si dhe personat përgjegjës duhet të anulojnë aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin, ndër të cilat: aktin nr. 247 (3400 prot.), dt. 20.9.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm, për emërimin në shërbimin civil, në periudhë prove njëvjeçare, të punonjësit *****; aktin e konfirmimit si nëpunës civil nr. 837, dt. 17.2.2021, të nxjerrë nga ana e eprorit direkt; si dhe, aktin nr. 62 (990 prot.), dt. 18.2.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, për transferimin e përhershëm të këtij punonjësi në pozicionin “Specialist në Sektorin e Çështjeve Juridike”, në Drejtorinë Juridike dhe Licencave.
3. Për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me punonjësit *****, “Drejtor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes” dhe *****, “Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit”, të cilët në momentin e dorëzimit të dokumentacionit për procedurat e ngritjes në detyrë, nuk plotësonin një nga kushtet minimale të pranimit që është vlerësimi i fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”, përcaktuar në pikën 2/c të VKM nr. 242, dt. 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse të marrë masat për të rikthyer këta punonjës në pozicionet e nivelit ku ata e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3** muaj nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
7. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Mediave Audiovizive, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA